



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

*Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
Ministry of Finance, Labour and Transfers*

THIRRJE PËR BASHKËPUNIM PËR ORGANIZATAT JO-QEVERITARE
FUSHËVEPRIMTARIA E TË CILAVE NDËRLIDHET ME MBËSHTETJEN E
PERSONAVE ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Konteksti

Në kuadër të realizimit të masave konkrete të Pakos së Ringjalljes Ekonomike, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT) ka planifikuar të ofrojë mbështetje për personat me aftësi të kufizuara. Mbështetja për aftësimin profesional ofrohet në formën e trajnimeve që realizohen nëpërmjet organizatave jo-qeveritare. Rrjedhimisht, të gjitha organizatat të cilat fushë të veprimtarisë kanë punën me persona me aftësi të kufizuara, mund të aplikojnë për të qenë implementuese të Masës 1.6, në kuadër të Pakos së Ringjalljes Ekonomike.

Qëllimi

Implementimi i masës 1.6 synon aftësimin profesional të personave me aftësi të kufizuara, që të jenë të barabartë në punësim dhe të ofrohet qasje jo-diskriminuese në tregun e punës. Aftësimi profesional do të realizohet përmes trajnimeve që zhvillohen në shoqëri tregtare (biznese) ose entitete, të cilat identifikohen nga OJQ-të që zgjedhen për implementimin e Masës 1.6.

Më pas biznesi ose entiteti ku është realizuar trajnimi mund të lidhë marrëdhënie të rregullt pune me të trajnuarit, ku edhe për punësimin e të trajnuarve do të ketë mbështetje përmes kësaj mase.

Kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen

1. Të jetë organizatë jo-qeveritare e regjistruar në Republikën e Kosovës sipas legjislacionit përkatës në fuqi;
2. Të ketë fushë të veprimtarisë punën me persona me aftësi të kufizuara;
3. Të zhvillojë të gjitha aktivitetet e organizatës apo entitetit sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Dokumentet e nevojshme dhe mënyra e aplikimit

Aplikacionet duhet të dërgohen përmes e-mail adresës: masa1.6@rks-gov.net deri më datë 15 Prill 2022, dhe duhet të përmbajnë dokumentacionin në vijim:

1. Çertifikatën e regjistrimit të entitetit;
2. Dëshminë rreth punës së OJQ-së (misioni, vizioni, aktivitetet, numri i anëtarëve etj);
3. Planin e aktiviteteve të OJQ-së për implementimin e masës 1.6.

Mënyra e subvencionimit

1. Personat me aftësi të kufizuara që marrin pjesë në trajnime, përfitojnë 170 euro në muaj, për tre deri në gjashtë muaj;
2. Bizneset në të cilat zhvillohen trajnimet, përfitojnë nga 100 euro në muaj për person, për tre deri në gjashtë muaj;

3. Personave me aftësi të kufizuara që pas trajnimit lidhin marrëdhënie të rregullt pune me biznesin ose entitetin, u subvencionohet paga në vlerë prej 270 euro në muaj, për gjashtë muaj pas trajnimit.

Procesi i përzgjedhjes

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve përmes një vendimi të veçantë do të themelojë një Komision të pavarur për shqyrtimin e aplikacioneve. Pas shqyrtimit të aplikacioneve, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do të lidhë marrëveshje për përcaktimin e përgjegjësive të palëve me organizatat e aprovuara nga Komisioni.

Palët e interesuara mund të kërkojnë sqarime shtesë për këtë thirrje publike nëpërmjet e-mail adresës: zyraesekretarit.mf@rks-gov.net.